



Financuar nga
Bashkimi Evropian

EURALIUS
Consolidation of the
Justice System in Albania

Heqje dorë nga përgjegjësia:

Jeni të lutur të vini re se ky dokument përbën një përkthim dhe konsolidim jozyrtar të destinuar vetëm për qëllime informimi. Teksti nuk jep asnjë të drejtë dhe nuk imponon asnjë detyrim të ndryshëm nga çfarë parashikohet në legjislacionin e miratuar dhe të botuar në Fletoren Zyrtare. EURALIUS nuk garanton saktësinë dhe nuk mban përgjegjësi për përdorimin që mund t'i bëhet informacionit të mëposhtëm.

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

**MBI KRITERET E VLERËSIMIT, PIKËZIMIT DHE RENDITJES SE KANDIDATËVE JOGJYQTARE DHE
PROCEDUREN E PERZGJEDHJES PER EMERIM NË GJYKATËN E LARTË**

Mbështetur në piken 12, të nenit 49, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", Këshilli i Lartë Gjyqësor,

VENDOSI:

I. Qellimi dhe objekti

1. Qellimi i këtij vendimi është përcaktimi i kritereve të vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes, si edhe të rregullave më të hollësishme mbi procedurën e përzgjedhjes dhe emerimit të kandidatëve jogjyqtare në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, si edhe, për aq sa gjejnë zbatim, për caktimin në pozicion, levizjen paralele dhe zhvillimin e karrierës të subjekteve të përcaktuara në Kreun VI të këtij Vendimi, në funksion të realizimit të një procesi të rregullt ligjor dhe në respektim të parimeve të përgjithshme të procedurës administrative.
2. Ky vendim parashikon rregulla më të detajuara në lidhje me:
 - a) Kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtare për një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë;
 - b) Veprimet dhe procedurat që Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të kryejë për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve jogjyqtarë, në funksion të përzgjedhjes dhe propozimit për t'u emëruar, në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, të juristit më të spikatur.

II. Kuadri ligjor

1. Ky Vendim do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me:



- a. Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë;
- b. Kodin e Procedurave Administrative;
- c. Ligjin nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (Ligji për Qeverisjen);
- ç. Ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (Ligji për Statusin);
- d. Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- dh. Ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- e. Ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;
- ë. Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- f. Ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- g. Ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësit civilë”, i ndryshuar.

III. Përkufizime

1. “Procedura e perzgjedhjes së kandidatëve për emerim”, me poshtë referuar edhe si “procedura e perzgjedhjes së kandidatëve”, është procesi administrativ i vlerësimit, pikezimit dhe renditjes së kandidatëve i finalizuar me vendimin për propozimin për emerim të një kandidati në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.
2. “Vendim vlerësimi dhe pikezimi” është vendimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor i marrë në kuadër të një procedure perzgjedhje të kandidatëve për emerim dhe që përmban vlerësimin dhe pikezimin e të gjithë kandidatëve të kualifikuar për t’u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë.
3. “Kandidate të kualifikuara për t’u emëruar në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë” janë të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses verifikimin e kushteve ligjore të emerimit, të pasurisë dhe të

figures, sipas kuptimit të Vendimit të Keshillit të Lartë Gjyqësor Nr.75, datë 23.05.2019, “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emerimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”.

4. “Listë e kandidatëve me të mire” është lista me emrat e jo më shumë se 5 kandidatëve të përfshirë në një procedurë perzgjedhje të kandidatëve për emerim, të cilët janë vlerësuar dhe renditur paraprakisht me të mire, nga Keshilli i Lartë Gjyqësor, në kuadër të kësaj procedure. Këta kandidatë duhet të merren në pyetje nga Keshilli në një seancë dëgjimore, me qëllim për të marrë informacion mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, cilësitë morale dhe aftësitë e tyre profesionale sa i përket ekspertizës së veçantë në fushën të veçantë të ligjit në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lire, manifestimit të aftësive profesionale në dokumentet ligjore ose publikimet shkencore dhe artikujt akademikë në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ata, rezultateve të studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, të përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër, si dhe manifestimit të aftësive gjuhësore.
5. “Vendim propozimi për emërim” është vendimi i Keshillit të Lartë Gjyqësor që merret në përfundim të një procedure perzgjedhje të kandidatëve për emerim dhe që i dërgohet Presidentit të Republikës, vendim ky që duhet të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kritereve ligjore të të gjithë kandidatëve për një pozicion të lire, përveç se duhet të përmbajë edhe renditjen e tyre, duke filluar nga kandidati që është vlerësuar me të mire.
6. “Këshill” është Këshilli i Lartë Gjyqësor.
7. “Komision” është Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë Keshillit të Lartë Gjyqësor, në përbërje të të cilit janë 3 anëtarët e përhershëm dhe/ose 2 anëtarët zëvendësues. Në rastet kur, për arsye që lidhen me ngarkesën dhe efektivitetin e punës, Keshilli vendos që në procedurat e shortit, për caktimin e relatorit për një procedurë perzgjedhje të kandidatëve për emerim, të përfshihen edhe anëtarët zëvendësues, Komisioni në çdo rast përbehet patjetër nga Kryetari dhe një anëtar i përhershëm, nga radhët e gjyqtarëve ose jogjyqtarëve, në varesi të radhëve nga vjen anëtar i zëvendësues i caktuar si relator.
8. “Relator” është anëtar i Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, anëtar i përhershëm ose anëtar i zëvendësues, i zgjedhur me short, për të kryer një procedurë perzgjedhje të kandidatëve për emerim.
9. “Ekspert” është specialisti i një fushe të caktuar, që përzgjidhet nga listat e përditësuara të subjekteve të licencuar për fushën përkatëse nga organi kompetent sipas ligjit ose ndërmjet atyre që e ushtrojnë veprimtarinë në institucione apo subjekte të tjera të specializuara, të tilla si perkthyes, specialist për verifikim plagjiature, akademik për vlerësim të publikimeve shkencore dhe artikujve akademikë në fushën e ligjit, etj.

IV. Kriteret për vlerësimin e kandidatëve, pesha e tyre specifike dhe pikëzimi

1. Vlerësimi, pikëzimi dhe renditja e kandidatëve për pozicionet e lira në Gjykatën e Lartë ka për qëllim identifikimin e kandidatit që përfaqëson juristin me të spikatur në kuptim të nenit 136, pika 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 49, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Identifikimi i kandidatit që përfaqëson juristin me të spikatur, bazohet në këto kategori kriteresh :
 - a. meritat profesionale;
 - b. meritat morale dhe etike;
 - c. meritat organizative, drejtuese dhe menaxheriale.
3. Për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve Këshilli mbështetet në këta tregues :
 - a) ekspertizen e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë, duke patur parasysh për këto nenin 31 të Ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
 - b) vlerësimi i punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion në pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit sipas rëndësisë së punimit, nepermjet të cilave tregohen të dhëna edhe për pjesëmarrjen e kandidatit në aktivitete shkencore, në procese të hartimit ose të konsultimit të legjislacionit apo në çdo angazhim tjetër profesional, përveç edhe për cilësinë e platformës dhe të vizionit të kandidatit, për aftësitë e tij për të marrë vendime dhe përgjegjësi referuar përvojave të mëparshme profesionale dhe shoqërore, për aftësitë e komunikimit, për aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturale, si edhe për aftësitë e përfaqësimit publik të kandidatit;
 - c) rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër;
 - ç) reputacionin që kandidati gëzon në shoqëri dhe midis kolegëve, cilësitë e tij morale, të tilla si ndershmëria, përpikëria në ushtrimin e detyrave, drejtësia në marrjen e vendimeve, përgjegjshmëria, besueshmëria, paanësia, dinjiteti dhe prirja për të marrë përsipër përgjegjësi, si dhe angazhimi i provuar në ndjekje të kauzave të shoqërisë civile;

d) aftësitë gjuhësore të kandidatit, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.

4. Detajimi i mëtejshëm i kategorive të kriterëve të vlerësimit dhe i treguesve për secilën nga ato, përcaktimi i peshës specifike të tyre në pikëzimin e kandidatëve, përcaktohet në Shtojcën e këtij Vendimi.
5. Për efekt të renditjes së kandidateve, pikëzimi përfundimtar i kandidatit të vlerësuar është shuma e pikëve që rezultojnë nga vlerësimi i secilit prej kriterëve të vlerësimit.
6. Ndarja e kriterëve, lista e treguesve që mund të merren parasysh në secilën kategori, pikëzimi maksimal i secilës prej tyre, burimet dokumentare dhe metoda e vlerësimit përcaktohen në mënyrë të hollësishme nga Shtojca “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve jogjyqtarë për në Gjykatën e Lartë” e këtij Vendimi.
7. Këshilli, me akt të veçantë, miraton metodologjinë mbi të cilën bazohet për vlerësimin dhe caktimin e pikëve lidhur me secilin prej kriterëve dhe treguesve të treguar në Shtojcën e këtij Vendimi.

V. Rregulla të përgjithshme të procedurës së perzgjedhjes së kandidateve

A. Fillimi dhe fazat e procedurës së perzgjedhjes së kandidateve

1. Procedura e perzgjedhjes së kandidateve për emerim në një pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë, fillon me vendim të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë, nga vendimi i parë përfundimtar i Këshillit për kualifikimin për emerim të një kandidati për atë pozicion të lirë.
2. Procedura e perzgjedhjes së kandidateve për një pozicion të lirë vazhdon krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatet e tjere që kanë kandidojnë për atë pozicion të lirë. Vetëm kandidatet e kualifikuar për t’u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor behen pjesë e procedurës së perzgjedhjes së kandidateve për emerim për atë pozicion të lirë.
3. Në të njëjtën ditë të mbledhjes së Këshillit për fillimin e procedurës së perzgjedhjes së kandidateve për një pozicion të lirë, Këshilli zhvillon edhe procedurën e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit të asaj procedure të perzgjedhjes së kandidateve. Përmes shortit realizohet shpërndarja rastësore dhe e barabartë, në vijimesi, e ngarkesës së punës sa i përket procedurave të ndryshme të perzgjedhjes së kandidateve, midis anëtarëve të Komisionit. Këshilli, për arsye të motivuara, mbi kërkesë të çdo anëtari të Komisionit, mund të vendosë përjashtimin e tij nga shorti.

4. Perjashtimisht, per arsye te motivuara qe lidhen me ngarkesen dhe efektivitetin e punes, mbi propozimin e Komisionit, Keshilli mund te vendos qe ne procedurat e shortit, per caktimin e relatorit ne nje ose disa procedura te perzgjedhjes se kandidateve per emerim, te përfshihen edhe anetaret zevendesues te Komisionit.
5. Anëtari i Komisionit dhe/ose cdo anetar tjetër i Keshillit, ne cdo kohe kur vjen ne dijeni per ekzistencen e nje konflikti interesi ose të një pengese ligjore sipas neneve 72, 73, 74 dhe 75 te Ligjit per Qeverisjen, është i detyruar të deklarojë natyrën e interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja ne proceduren e perzgjedhjes se kandidateve per ate pozicion te lire, ne mbledhjet e Komisionit ose në mbledhjen plenare të Këshillit.
6. Anëtari i Komisionit dhe/ose cdo anetar tjetër i Keshillit, qe me heret ka dhene doreheqjen ose eshte perjashtuar ne nje procedure verifikimi te kushteve dhe kriterëve ligjore te emerimit, te pasurisë dhe te figures per nje nga kandidatet qe kandidojne për ate pozicion te lire per te cilin zhvillohet procedura e perzgjedhjes se kandidateve, nuk mund te marre pjese ne kete procedure ne rast se konflikti i interesit ose pengesa ligjore per shkak te te cilit ai ka dhene dorëheqjen ose eshte përjashtuar, vijon te ekzistojë.
7. Per dorëheqjen e cdo anetari te Keshillit vendos Kryetari i tij. Kur dorëheqjen e jep Kryetari i Keshillit, vendimi merret nga Zëvendëskryetari i tij.
8. Relatori i ceshtjes kujdeset për zhvillimin e procedures se perzgjedhjes se kandidateve per emerim dhe sidomos për sa më poshtë:
 - a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati;
 - b) përgatitjen e projektakteve administrative;
 - c) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
 - ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
 - d) njoftimet për kandidatin.
9. Procedura e perzgjedhjes se kandidateve per emerim per nje pozicion te lire realizohet në pese faza:
 - a) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit te ceshtjes;

- b) shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak te vleresimit dhe pikezimit te kandidateve;
- c) shqyrtimi dhe miratimi nga Keshilli i projektvendimit paraprak te vleresimit dhe pikezimit te kandidateve, si te listes se kandidateve me te mire;
- ç) intervistimi nga Keshilli i kandidatëve me te mire te listuar;
- c) shqyrtimi dhe miratimi nga Keshilli i projektvendimit perfundimtar te vleresimit dhe pikezimit te kandidateve, si dhe te projektvendimit të propozimit per emerim.

B. Të drejtat e kandidatit

1. Kandidatet per nje pozicion te lire njoftohet per relatorin e procedures se perzgjedhjes se kandidateve menjehere me fillimin e kesaj procedure, permes publikimit ne faqen zyrtare ne internet te Keshillit te vendimit per caktimin e relatorit.
2. Kandidati ka të drejtë te kerkoje perjashtimin e relatorit te ceshtjes per një nga shkaqet e parashikuara në nenin 75 te Ligjit per Qeverisjen, jo me vone se 3 dite, nga lindja e shkakut te perjashtimit, duke shoqeruar kerkesen, kur eshte rasti, me aktet provuese te shkakut te perjashtimit. Kete te drejte kandidati e ka edhe ndaj cdo anetari tjetere te Keshillit.
3. Keshilli vendos për kerkesen e kandidatit per përjashtimin e relatorit te ceshtjes dhe/ose te cdo anëtari tjetere te Keshillit, jo me vone se 7 dite nga paraqitja e saj.
4. Kandidati ka të drejtë të përzgjedhë dhe të paraqesë pranë Këshillit dokumente që i çmon të nevojshme për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës sipas rregullave dhe kriterëve të përcaktuara në ligj dhe në këtë Vendim.
5. Kandidati ka të drejtë që, në çdo fazë të procedurës së perzgjedhjes se kandidateve per emerim, me kërkesën e tij, të njihet me dokumentet e dosjes së kandidimit dhe aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë Vendim.
6. Kryesisht apo mbi kërkesën e Këshillit, kandidati ka të drejtë të paraqesë shpjegime me shkrim për fakte, rrethana apo çështjet ligjore qe lidhen me kriteret e vleresimit, si dhe të depozitojë dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve.

7. Çdo kandidat i listuar me mire, mbi kërkesën e Këshillit, ka të drejtë të degjohet në seancë dëgjimore, mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, cilësitë morale dhe aftësitë e tij profesionale sa i përket : ekspertizës së veçantë në fusha të veçanta të ligjit në raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lire; manifestimit të aftësive profesionale në dokumentet ligjore ose publikimet shkencore dhe artikujt akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga ai; rezultateve të studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, të përvojës në profesion apo çdo trajnim tjetër; si dhe manifestimit të aftësive gjuhësore.
8. Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi deri sa Këshilli nuk ka përfunduar procedurën e perzgjedhjes së kandidatëve për emerim, duke njoftuar për këtë, me shkrim, Këshillin. Pas këtij njoftimi, me propozim të relatorit të ceshtjes, përcjellë nga Komisioni, Këshilli vendos menjëherë përfundimin e procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për emerim për këtë kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit. Akti i Këshillit për përfundimin e procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për emerim të këtij kandidati dhe përjashtimin e tij nga procedurat e mëtejshme të kandidimit, i njoftohet menjëherë kandidatit dhe bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

C. Afatet dhe llogaritja e tyre

1. Afatet në procedurën e perzgjedhjes së kandidatëve për emerim caktohen në ditë kalendarike.
2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në ligj ose në këtë Vendim, në llogaritjen e afatit përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja, nga e cila fillon të ecë afati.
3. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj.
4. Dita e fundit e afatit të kryerjes së veprimit procedural, paraqitjes së kërkesave dhe shpjegimeve, vazhdon deri në orën 24 të saj. Afati nuk quhet i humbur, kur kërkesa, shpjegimet ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit.

Ç. Njoftimet

1. Njoftimet e Këshillit drejtuar kandidatit gjatë procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për emerim bëhen me shkresë, në adresën elektronike të deklaruar nga ai për këtë qëllim, pranë Këshillit. Mbetet në detyrimin e kandidatit njoftimi menjëherë me shkrim i Këshillit për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës elektronike të deklaruar nga ai.

2. Njoftimet dhe kërkesat e kandidatit drejtuar Këshillit bëhen me shkrim, duke i depozituar drejtpërdrejt pranë Këshillit ose në adresën e tij elektronike, adrese e cila iu është bërë e njohur për këtë qëllim secilit kandidat, që në rastin e fillimit të procedurave të verifikimit të kandidaturave apo përmes publikimit të saj në faqen zyrtare të Këshillit.
3. Në rastet kur, për pamundësi objektive ose motive të tjera të justifikuara, kandidati nuk mund të paraqitet apo të paraqesë shpjegime dhe dokumente brenda afatit të përcaktuar në këtë Vendim, ai njofton menjëherë relatorin ose Këshillin. Kur i vlerëson motivet e parashtruara me shkrim si të justifikuara, relatori apo Këshilli i cakton kandidatit një afat të ri të arsyeshëm.

V. Fazat e procedurës së përzgjedhjes së kandidateve

A. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të ceshtjes

1. Veprimet përgatitore për realizimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidateve për një pozicion të lire zhvillohen krahas me procedurat e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjorë të emërimit, të pasurisë dhe të figurës për të gjithë kandidatet për atë pozicion të lire. Në procedurën e përzgjedhjes së kandidateve për një pozicion të lire përfshihen vetëm kandidatet e kualifikuar për t'u emëruar me vendim përfundimtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Relatori i ceshtjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale në lidhje me:
 - a) komunikimin me kandidatët sa i përket paraqitjes, pranimit dhe plotësimit të dokumenteve të nevojshme për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e tyre sipas përcaktimeve të ligjit dhe këtij Vendimi;
 - b) përgatitjen e dokumentacionit dhe paraqitjen e projektvendimeve të nevojshme për shqyrtim nga Komisioni dhe Këshilli lidhur me procedurën e përzgjedhjes së kandidateve.
3. Relatori i ceshtjes, krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese që i vlerëson të nevojshme rast pas rasti, realizon procedurat standarde si më poshtë:
 - a) administron kopje të plotë të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve;
 - b) njofton kandidatin për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar dokumentet e paraqitura, në rastet kur vlerëson se janë me mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit;

- c) përgatit dhe paraqit për shqyrtim relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve dhe përmbledhjen faktike të tyre për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;
 - ç) përgatit dhe paraqit për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe listen me kandidatet me të mire, që përmban, kur është rasti, emrat e jo me shumë se 5 kandidatëve, me piket me të larta;
 - d) përgatit dhe paraqit për shqyrtim projektvendimin për kalendarin e intervistave me kandidatët me të mire;
 - e) paraqit listën e ekspertëve që mund të jetë e nevojshme të thirren nga Këshilli në lidhje me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara nga kandidatet me të mire, me vlerësimin e nivelit të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit të përgatitura dhe paraqitura nga kandidatet me të mire apo të plagjiatures në këto dokumente, etj.
4. Në rastin e kandidatit që, njëkohësisht, ka shprehur interes për t'u emeruar në më shumë se një pozicion të lire në proces shqyrtimi nga Këshilli, pozicione për të cilët kërkohet ekspertizë e vecante në të njëjtën fushë të ligjit, procedura e perzgjedhjes së kandidatëve sa i përket këtij kandidati, si rregull, realizohet nga relatori i caktuar për procedurën e pare të perzgjedhjes së kandidatëve. Në rastin kur për këto procedura në proces ka një numër të ndryshëm kandidatësh, atëherë procedura e perzgjedhjes së kandidatëve në lidhje me kandidatin që, njëkohësisht, ka shprehur interes për t'u emeruar në më shumë se një pozicion të lire, realizohet nga relatori i asaj procedure që ka numrin më të vogël të kandidatëve. Në çdo rast, për këto kandidat do të ketë vetëm një procedurë perzgjedhjeje të kandidatëve për emerim, e cila do të jetë e vlefshme edhe për procedurat e tjera të perzgjedhjes së kandidatëve. Për këto, secili nga relatorët përkatës të procedurave perzgjedhese të kandidatëve administrojnë kopjen e plotë të dokumentacionit të paraqitur nga ky kandidat në procedurën e perzgjedhjes së kandidatëve, si dhe vendimin e Këshillit për vlerësimin dhe pikëzimin përfshirë edhe për këto kandidat, i marrë në kuadër të kesaj procedure.
5. Në ushtrimin e përgjegjësisë të tij relatori i çeshtjes ndihmohet nga Njësia Mbështetëse e Komisionit dhe personeli administrativ i Këshillit, të cilët kanë detyrimin të ndjekin procedurat, të kryejnë veprimet dhe të përgatisin aktet përkatëse, sipas udhëzimeve të relatorit të çeshtjes.
6. Dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe të Ligjit "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" mbi paañësinë e administratës publike zbatohen edhe për nepunesit e Njësise Mbështetëse të Komisionit dhe personelin administrativ të Këshillit.

7. Brenda 7 ditëve nga ajo e njoftimit publik ne faqen zyrtare te internetit te Keshillit ne lidhje me caktimin e relatorit per procedure perkatese te perzgjedhjes se kandidateve per nje pozicion te lire, kandidati i pare i kualifikuar per t'u emeruar ka detyrimin te dorezoje prane Keshillit dokumentet e nevojshme për përzgjedhjen, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij Vendimi. Per kandidatet e tjere, te kualifikuar me pas per t'u emeruar, ky afat fillon nga dita e njoftimit atyre te vendimit perkates te kualifikimit te Keshillit.
 8. Lista e dokumenteve që kandidati dorëzon në kopje origjinale ose të vërtetuar sipas ligjit përfshin:
 - a) jetëshkrimin e përditësuar me të dhënat deri në kohën e dorëzimit sipas pikës 7 të këtij Seksioni, të hartuar sipas formatit të përcaktuar nga Këshilli;
 - b) dokumentin që përshkruan motivimin e kandidimit dhe objektivat nëse emërohet;
 - c) pesë dokumente profesionale të përzgjedhura nga vetë kandidati për vlerësim sipas metodologjisë profesionale të miratuar nga Këshilli;
 - ç) dokumente të tjerë që shërbejnë për vlerësimin e kandidatit, sipas përcaktimeve orientuese në Shtojcën e këtij Vendimi, në zërin “Burimet e Vlerësimit”, për secilën kategori dhe kriter të vlerësimit;
 - d) deklarimin, nëse zotëron, të njohurive në gjuhë të huaja, të shoqëruar, nëse i disponon, me dokumente përkatëse vërtetuese të lëshuar nga subjekte publike ose private të specializuara.
 9. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga secili kandidat, relatori i ceshtjes vlerëson se ka mangësi të lidhura me vërtetësinë, rregullshmërinë ose plotësinë e përmbajtjes së dokumentit, njofton menjëherë kandidatin, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për të dhënë shpjegime apo për të saktësuar ose plotësuar mangësitë e dokumentit të paraqitur.
 10. Mungesa e përgjigjes së kandidatit për dhënien e shpjegimeve dhe për saktësimin ose plotësimin e mangësive për dokumentet e paraqitura, nuk pengon vijimin e veprimeve përgatitore të relatorit të ceshtjes për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatit.
 11. Njëkohësisht, ose menjëherë pas përgjigjes së dhënë nga kandidati sipas pikës 9 si me lart, si edhe kur vjen në dijeni për rrethana që vënë në dyshim vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave që përmbahen në dokumente të paraqitura nga kandidati, relatori i ceshtjes mund të kërkojë nga subjekte publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, shpjegime, të dhëna apo kopje të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.
-

12. Pas kryerjes së veprimeve përgatitore të parashikuara në pikat 7 deri 11 të këtij Seksioni dhe duke u bazuar në procedurat dhe kriteret e përcaktuara në ligj, të detajuara në këtë Vendim dhe në Shtojcën e tij, relatori i ceshtjes:

- a) shqyrton dhe përgatit dokumentacionin e secilit kandidat për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidaturës;
- b) përgatit relacionin që përmban përshkrimin e procedurave të ndjekura gjatë veprimeve përgatitore, të dokumenteve të paraqitura nga kandidati apo të ardhura nga subjekte publike a private mbi kërkesën e relatorit, përmbledhjen faktike të përmbajtjes së këtyre dokumenteve për qëllime të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatit, si edhe kopje të këtyre dokumenteve bashkëlidhur relacionit;
- c) përgatit dhe paraqit për shqyrtim projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikezimit të kandidatëve, si dhe listen me kandidatet me të mire;
- ç) përgatit dhe paraqit për shqyrtim projektvendimin për kalendarin e intervistave me kandidatët me të mire.

13. Veprimet përgatitore për procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së një kandidati ndërpriten në rastin kur Këshilli vendos përfundimin e procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për këto kandidat dhe përjashtimin e tij nga procedurat e metejshme të kandidimit.

14. Në përfundim të verifikimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e perzgjedhjes për emerim në një pozicion të lire, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e perzgjedhjes së kandidatëve, projektvendimin paraprak të vlerësimit dhe pikezimit të kandidatëve, si dhe listen me kandidatet me të mire.

B. Shqyrtimi dhe miratimi nga Komisioni i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikezimit të kandidatëve, si dhe të listës së kandidatëve me të mire

1. Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 5 ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.
 2. Në mbledhjen e Komisionit, Kryetari fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për emerim për atë pozicion të lire.
-

3. Komisioni, pasi dëgjon paraprakisht diskutimin e relatorit të ceshtjes, bisedon dhe vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill nëse procedura perzgjedhjes së kandidatëve është e plotë ose i kërkon relatorit të ceshtjes vijimin e kësaj procedure, duke evidentuar dhe veprimet procedurale dhe/ose ceshtjet që kanë nevojë të verifikohen më tej.

4. Relatori i ceshtjes ka detyrimin të kryejë veprimet dhe/ose verifikimet e evidentuara nga Komisioni, në përfundim të të cilave njofton Kryetarin e Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, duke vijuar procesin me pas sipas pikave 1 deri 3 të këtij Seksioni.

C. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikezimit të kandidatëve, si dhe të listës me kandidatët me të mirë

1. Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga Kryetari i Komisionit për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke i dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Mbledhja zhvillohet jo më vonë se 7 ditë nga ajo e njoftimit të Kryetarit të Komisionit.

2. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori i ceshtjes, i njoftohet kandidatit. Ky njoftim bëhet publik edhe në faqen zyrtare të Këshillit.

3. Në mbledhjen e Këshillit, Kryetari i Këshillit fton relatorin e çështjes që të paraqesë përmbledhjen e veprimeve procedurale të kryera, si edhe të fakteve dhe të gjetjeve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së perzgjedhjes së kandidatëve për emerim për atë pozicion të lirë.

4. Në përfundim të parashtrimeve të relatorit të ceshtjes, nëse vlerësojnë, anëtarët e Këshillit mund t'i drejtojnë pyetje dhe të kërkojnë shpjegime të natyrës sqaruese.

5. Nëse anëtarët e Këshillit nuk parashtrojnë pyetje dhe kërkesa të tjera sqaruese në drejtim të relatorit të ceshtjes, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për keto çështje, sipas rendit të mëposhtem:

a. plotësimin e veprimeve procedurale të kryera gjatë fazës së veprimeve përgatitore dhe plotësimin e dokumentacionit të paraqitur për vlerësim nga ana e të gjithë kandidatëve;

b. miratimin e projektvendimit paraprak të vlerësimit dhe pikezimit të kandidatëve;

c. miratimin e listës me kandidatët me të mirë;

ç) përcaktimin e kalendarit të intervistave me kandidatët me të mirë;

- f) caktimin, kur eshte rasti, te ekspertit te nevojshem per t'u thirrur ne lidhje me vlerësimin e nivelit të zotërimit të gjuhëve të huaja të deklaruara nga kandidatet me te mire, me vlerësimin e nivelit te publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit te pergatitura dhe paraqitura nga kandidatet me te mire apo te plagjiatures ne keto dokumente, etj.
6. Në përfundim të bisedimeve, Keshilli kalon ne votim per secilen nga ceshtjet e renditura ne piken 5 te ketij Seksioni, ku i pari voton relatori i ceshtjes, i pasuar nga anetaret e Komisionit, me tej anetaret e tjere te Keshillit dhe ne fund Kryetari i Keshillit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit te Keshillit është përcaktuese.
7. Nëse gjate bisedimeve Keshilli vlereson dhe vendos qe veprimet procedurale te kryera gjatë fazes se veprimeve përgatitore dhe/ose dokumentacioni i paraqitur për vlerësim nga kandidatet nuk eshte i plote, atehere nuk vijon me bisedimin e ceshtjeve te tjera te renditura ne piken 5 te ketij Seksioni, por shpall caktimin e një seance tjetër për shqyrtimin e çështjes. Ne kete rast, Keshilli ngarkon relatorin e ceshtjes te marre masa per plotesimin e mangesive te evidentuara, duke i caktuar nje afat. Ne seancen e radhes, qe caktohet jo me vone se 7 dite nga njoftimi i relatorit te ceshtjes, ky i fundit i paraqet para Keshillit aktet shtese. Ne kete rast Keshilli vijon bisedimet dhe vendos per ceshtjet e renditura ne piken 5 te ketij Seksioni.

Ç. Intervistimi nga Keshilli i kandidatëve te listuar me mire

1. Kandidatet e listuar me mire njoftohen për vendin, ditën dhe kohën e paraqitjes për intervistë, në një seancë dëgjimore, në mbledhjen e Këshillit. Njoftimi përmban edhe udhëzimet lidhur me natyrën dhe kohëzgjatjen e intervistës.
2. Në seancën dëgjimore Keshilli pyet kandidatet e listuar me mire, me qellim për të marrë informacion mbi motivet dhe objektivat e kandidimit, cilësitë morale dhe aftësitë e tyre profesionale sa i perket ekspertizës se veçantë në fusha të veçanta të ligjit ne raport me kërkesat e shpallura për pozicionin e lire, manifestimit te aftesive profesionale ne dokumentet ligjore ose publikimet shkencore dhe artikujt akademike në fushën e ligjit te pergatitura dhe paraqitura nga ata, rezultateve te studimeve të larta për drejtësi, të programit të formimit fillestar, te përvojës në profesion ose çdo trajnimi tjetër, si dhe manifestimit te aftësive gjuhësore.
3. Këshilli, kur ka vendosur thirrjen e ekspertit, njofton ate për vendin, ditën dhe kohëzgjatjen e shërbimit të kërkuar. Njoftimi përmban edhe udhëzimet e Këshillit lidhur me natyrën e shërbimit të kërkuar.

4. Në ditën dhe kohën e paracaktuar, pas deklarimit të hapjes së seancës, Këshilli verifikon paraqitjen e ekspertit, i kujton atij rëndësinë e detyrës për të cilën është thirrur dhe e fton të bëjë betimin se do të kryejë me profesionalizëm dhe me nder detyrën që i është besuar.
5. Pas betimit, ekspertit i behet e ditur objekti i ekspertimit, emri/emrat e kandidatit/kandidatëve të listuar me mire, aftësitë gjuhësore apo vlerat profesionale të publikimeve shkencore dhe artikujve akademike në fushën e ligjit të cilëve, Këshilli ka vlerësuar të nevojshme marrjen e mendimit të ekspertit, duke i kërkuar ketij të fundit të shprehet nëse është në kushte papajtueshmërie apo konflikti interesi me të/ta.
6. Këshilli thërret për intervistë secilin nga kandidatët e listuar me mire, duke i pyetur fillimisht, kur është rasti, nëse ka pretendime për gjendje papajtueshmërie a konflikti interesi me ekspertin e thirrur.
7. Pas orientimit për mënyrën e zhvillimit të intervistës dhe kohëzgjatjen e saj, kandidati i thirrur për intervistë ftohet për parashtrimin e lirë të motiveve dhe arsyeve të kandidimit dhe objektivave që synon të ndjekë nëse emërohet në pizicionin e lire të perkohshem.
8. Intervista vijon me pyetje të anëtarëve të Këshillit dhe përgjigjet e kandidatit.
9. Eksperti i thirrur nga Këshilli njihet me dokumentet objekt ekspertimi dhe, kur është rasti, bisedon me kandidatin e thirrur për intervistë. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallen e zoterimit të gjuhës së huaj, eksperti bisedon me kandidatin në gjuhën e huaj të deklaruar prej tij, për çështje të natyrës së përgjithshme dhe të fushës profesionale.
10. Brenda afatit që i caktohet nga Këshilli, eksperti harton mendimin me shkrim në lidhje me ceshtjet e shtruar për ekspertim. Nëse eksperti është thirrur për të vlerësuar shkallen e zoterimit të gjuhës së huaj nga secili prej kandidatëve të listuar me mire, ai e bën këtë vlerësim sipas kriterëve dhe mënyrës së vlerësimit të përcaktuar në Shtojcën e këtij Vendimi dhe **në metodologjinë e miratuar nga Këshilli për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve.**

D. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli i projektaktit perfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit të kandidatëve, si dhe të projektaktit të propozimit për emerim

1. Pas dorezimit nga eksperti të mendimit me shkrim për ceshtjet e shtruar për ekspertim, jo më vonë se 7 ditë nga dorezimi i mendimit, ceshtja shqyrtohet në mbledhjen e Këshillit.
 2. Këshilli shqyrton fillimisht dhe vendos në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat.
-

3. Vlerësimi dhe pikëzimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës dhe kriterëve të parashikuara në ligj dhe në rregullat e detajuara të këtij Vendimi e të Shtojcës bashkëlidhur. Ky vlerësim mbështetet në dokumentacionin e paraqitur dhe, kur është rasti, edhe në intervistat e realizuara me kandidatet.
4. Cdo anetar i Këshillit vlerëson meritat dhe bën pikëzimin me shkrim, në formë tabelare, për secilin kandidat. Relatori diskuton e parashtron i pari arsyetimin mbi vlerësimin e meritave të kandidatit dhe depoziton pikëzimin me shkrim për secilin kriter, i pasuar nga anetarët e Komisionit, me tej nga anetarët e tjerë të Këshillit dhe, në fund, Kryetari i Këshillit.
5. Këshilli vijon shqyrtimin e ceshtjes dhe vendos në lidhje me vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat, bazuar në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përgatitur nga relatori i ceshtjes dhe të miratuar paraprakisht nga Komisioni. Në projektvendimin përfundimtar të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, përveç pikëve për secilin kriter dhe totalit të pikëve, pasqyrohet edhe arsyetimi për vlerësimin e kandidatit nga Këshilli në lidhje me secilin prej kriterëve.
6. Rezultati i pikëzimit për secilin prej kriterëve, për cdo kandidat, rezulton nga pjesëtimi i shumës së pikëve totale të caktuara nga të gjithë anëtarët e Këshillit me numrin e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
7. Këshilli, pasi verifikon dhe bindet për saktësinë e projektvendimit të vlerësimit dhe pikëzimit për secilin kandidat, e miraton atë.
8. Pas vlerësimit dhe pikëzimit të secilit kandidat, në mbledhjen e radhës, Këshilli vijon shqyrtimin e ceshtjes dhe vendos në lidhje me renditjen e kandidatëve, bazuar në projektvendimin e renditjes së kandidateve, përgatitur nga relatori i ceshtjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni.
9. Rënditja e kandidateve bëhet duke u bazuar në rezultatin e pikëzimit për secilin nga ata.
10. Në rast të rezultateve të njëjta të pikëve mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga vitet e eksperiencës profesionale të përshtatshme për pozicionin e lirë. Në rast se edhe pas kësaj ka barazi mes kandidatëve, renditja e tyre përcaktohet nga njohuritë e gjuhës së një shteti anëtar të Bashkimit Evropian.
11. Këshilli, pasi verifikon dhe bindet për saktësinë e projektvendimit të renditjes së kandidateve, e miraton atë.
12. Pas vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve, në mbledhjen e radhës, Këshilli vijon shqyrtimin e ceshtjes dhe vendos në lidhje me projektvendimin e propozimit për emerim, përgatitur nga relatori i ceshtjes dhe i miratuar paraprakisht nga Komisioni. Projektvendimi i propozimit për emerim duhet

të jetë i arsyetuar në lidhje me përmbushjen e kriterëve ligjore prej kandidatëve, si dhe duhet të pasqyrojë renditjen e tyre perfundimtare.

13. Keshilli, pasi verifikon saktësinë dhe plotësinë e arsytimit të projektvendimit të propozimit për emerim, e miraton atë. Relatori i ceshtjes, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, harton vendimin e propozimit për emerim, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rene dakort shumica e anëtarëve të Keshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Keshillit që kanë marrë pjesë në procedurën e perzgjedhjes së kandidatëve për emerim për atë pozicion të lirë.
14. Vendimi i Keshillit për propozim për emerim në një pozicion të lirë, publikohet në faqen e tij zyrtare dhe u njoftohet të gjithë kandidatëve të përfshirë në procedurën e perzgjedhjes për emerim, të cilët kanë të drejtën të paraqisin ankime, brenda 5 ditëve, në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë.
15. Në rastin kur gjykata pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin e Keshillit, ky i fundit, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e propozimit për emerim, në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës.
16. Vendimi i Keshillit për propozim për emerim, që ka marrë formë të prerë sipas ligjit, i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.
17. Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mosëmërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit me renditjen më të lartë, ky dekret shqyrtohet nga Keshilli, jo më vonë se një javë nga depozitimi i tij pranë Keshillit.
18. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosëmërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të Keshillit, jo më pak se gjashtë anëtarë të tij.
19. Nëse shumica e anëtarëve të Keshillit voton në favor të Dekretit të Presidentit të Republikës për mosëmërimin e kandidatit, Keshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të jogjyqtareve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emerim kandidatin e renditur i dyti me lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

VI. Zbatimi me analogji i vendimit

1. Kriteret për vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve të parashikuara në këtë Vendim zbatohen, për aq sa gjejnë zbatim, edhe për ato procedura të perzgjedhjes së kandidatëve që rregullohen nga Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtareve dhe prokurorëve në Republikën e

Shqiperise” dhe qe referojne drejtperdrejte ose tërthorazi ne nenin 49 të tij, konkretisht ne procedurat qe lidhen me :

- a) Caktimin në pozicion te ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 39, pika 4, shkronja “a”;
- b) Lëvizjen paralele te ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 36, referuar nenit 43, pika 8, shkronja “b” dhe pika 9;
- c) Zhvillimin e karrieres së gjyqtarëve te komanduar, referuar nenit 53, pika 11;
- ç) Caktimin në pozicion te ish-gjyqtarëve të riemëruar sipas nenit 166, referuar pikes 5 te kesaj dispozite.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA

KRITERET E VLERËSIMIT DHE METODOLOGJIA E PIKËZIMIT TË KANDIDATËVE JO-GJYQARË PËR TU EMËRUAR GJYQARË NË GJYKATËN E LARTË

MERITAT PROFESIONALE			TOTALI PIKËVE	PIKËT NGA KLGj	
			75		
KRITERET LIGJORE TË VLERËSIMIT	BURIMET E VLERËSIMIT (LISTË JOSHTERUESE)	INDIKATORË VLERESUES PËR PIKËZIMIN (LISTË JOSHTERUESE)	PIKËZIMI MAKSIMAL I GRUPIT TË KRITEREVE	PIKËT NGA KLGj	TË DHËNA PËR METODOLOGJINË
A. Historiku arsimor dhe e shkuara profesionale <i>Ligji nr. 96/2016 per statusin e gjyqtareve dhe prokuroreve, Neni 49(6)</i>			20		
<u>Rezultatet e studimeve:</u> Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c) “rezultatet e studimeve të larta për drejtësi, (...)”	Jetëshkrimi. Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve të ndjekura, sipas rastit nga institucione të arsimit të lartë, brenda dhe jashtë vendit.	Niveli i rezultateve të arritura gjatë studimeve për drejtësi	2		1 pikë - për rezultatet e studimeve të larta për drejtësi për mesatare të notave 8-9 2 pikë - për rezultatet e studimeve të larta për drejtësi për mesatare të notave

<p><u>Rezultatet e programeve të formimit fillestar:</u></p>	<p>Jetëshkrimi.</p>	<p>Niveli i rezultateve të arritura gjatë studimeve në programet e formimit fillestar</p>	<p>2</p>	<p>9,1 - 10</p> <p>1 pikë - për rezultatet e studimeve në programin e formimit fillestar për vlerësim “Mirë/Shumë mirë” (vlerësimi një nivel më pak se niveli maksimal – sipas programit)</p>
<p>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c) “rezultatet (...) të programit të formimit fillestar”</p>	<p>Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me ecurinë e kryerjes së studimeve në programet e formimit fillestar.</p>			<p>2 pikë – për rezultatet e studimeve në programin e formimit fillestar për vlerësim “Shumë mirë/Shkëqyeshëm” (vlerësimi për nivelin maksimal – sipas programit)</p>
<p><u>Rezultatet e përvojës në profesionin e juristit:</u></p>	<p>Jetëshkrimi.</p>	<p>Niveli i rezultateve të arritura gjatë përvojës në profesionin e juristit</p>	<p>4</p>	<p>2 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë përvojës për vlerësim “Mirë” ose “Shumë</p>
<p>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c) “rezultatet (...e) përvojës në profesion”</p>	<p>Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me rezultatet/vlerësimin/ecurinë përgjatë përvojës</p>			

<p><u>Rezultatet e trajnimeve të tjera, kualifikimeve pasuniversitare, dhe gradat/titujt shkencore:</u></p> <p><u>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(c)</u> “rezultatet (...e) çdo trajnimi tjetër”</p>	<p>në profesionin e juristit</p> <p>Jetëshkrimi.</p> <p>Informacione dhe dokumente zyrtare lidhur me trajnimet e tjera, kualifikimeve pasuniversitare, si dhe gradat shkencore brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Niveli i rezultateve të arritura gjatë trajnimeve të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit</p> <p>Niveli i kualifikimeve pasuniversitare</p> <p>Lloji i trajnimeve dhe studimeve pasuniversitare</p> <p>Institucioni arsimor dhe trajnues</p>	<p>8</p>	<p>mirë” (vlerësimi një nivel më pak se niveli maksimal - sipas llojit të profilit)</p> <p>4 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë përvojës për vlerësim “Shumë mire” ose “Shkëlqyeshëm” (vlerësimi për nivelin maksimal - sipas llojit të profilit)</p> <p>0,5 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve afat-shkurtra/afatmesme (deri në 2 javë) të kryera në Shqipëri, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit)</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

		<p>Institucioni arsimor që ka dhënë titullin shkencor, ne Shqiperi apo në vendet e OECD/BE.</p> <p>Lloji, profili dhe tematika të dhënies së titullit akademik.</p>		<p>1 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve shkurtra/afatmesme (deri në 2 javë) të kryera në vendet e BE/OECD, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit)</p> <p>1 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve afat-gjata (nga 15 ditë – 1 semestër akademik) të kryera në Shqipëri, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit)</p> <p>2 pikë - për rezultatet e arritura përgjatë trajnimeve afat-gjata</p>
--	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

				<p>(nga 15 ditë – 1 semestër akademik) të kryera në vendet e BE/OECD, të cilat në fund të tyre kanë edhe komponentin e vlerësimit (në 10 vitet e fundit)</p> <p>2 pikë - për studimet (rezultatet) pasuniversitare (master në ligj) të kryera në Shqipëri</p> <p>3 pikë - për studimet (rezultatet) pasuniversitare (master në ligj) të kryera në vendet e BE/OECD</p> <p>2 pikë - për rezultatet e larta përgjatë studimeve të doktoraturës në ligj të kryera në Shqipëri</p>
--	--	--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

(95-100 pikë)

3 pikë - për rezultatet e larta përgjatë studimeve të doktoraturës në ligj të kryera në vendet e BE/OECD
(95-100 pikë)

Pikët për gradat

shkencore:

2 pikë - për titullin Profesor i Asociuar në Shqipëri

3 pikë - për titullin Profesor i Asociuar në vendet e BE/OECD

3 pikë - për titullin Profesor në Shqipëri

4 pikë - për titullin Profesor/Profesor Emeritus në vendet e BE/OECD

<p><u>Aftësitë gjuhësore:</u></p> <p><i>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(ç)</i> ç) aftësitë gjuhësore, të treguara nëpërmjet certifikatave dhe gjatë intervistimit.</p> <p><i>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(3)</i> “Kandidati që ka njohuri të një gjuhe të një shteti anëtar të Bashkimit Evropian ka përparësi në vlerësim.”</p>	<p>Jeteshkrimi.</p> <p>Informacione dhe dokumente zyrtare konkrete lidhur me certifikimin ose evidentimin e zotërimit të gjuhëve të huaja, duke përfshirë dokumentet që provojnë studimet dhe punën jashtë vendit.</p> <p>Intervista dhe mendimi i ekspertit.</p> <p>Botime ose dokumente të përgatitura dhe të dorëzuara nga kandidati në gjuhën përkatëse</p>	<p>Lloji, shkalla e zotërimit dhe institucioni ku është vlerësuar njohja e gjuhës së huaj.</p>	<p>4</p>	<p>Këshilli mund të konsiderojë të vlerësojë dhe të pikezojë me përparësi, sidomos njohuri në gjuhën angleze dhe franceze (gjuhët e GJEDNJ).</p> <p>1,5 pikë - Anglisht (0,5 pikë për secilin nga tre nivelet)</p> <p>1,5 pikë për Frëngjisht (0,5 pikë për secilën nga tre nivelet)</p> <p>1 pikë - për të gjitha dhe çdo gjuhë tjetër të BE-së (0,5 pikë për secilin nga dy nivelet)</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

B. Kualifikimi i përgjithshëm profesional <i>Kushtetuta, Neni 136(3); Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b)</i>			25		
Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b) b) vlerësimin e punës së kandidatit, përmes të paktën pesë dokumenteve ligjore, të hartuara nga kandidati gjatë përvojës së tij në profesion gjatë pesë viteve të fundit, si dhe çdo publikim shkencor dhe artikull akademik në fushën e ligjit;	Jetëshkrimi Punime dhe dokumente profesionale të kandidatit, të përgatitura në përmbushje të funksioneve dhe veprimtarive profesionale, sipas profilit përkatës, ku përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to: - vendime gjyqësore - kontrolli incidental, - kërkesa për gjykim, - pretenca, padi, parashtresa të mbrojtjes së çështjes, mjete të kundërshtimit të vendimeve, - akte administrative dhe parashtrime në praktika administrative të përgatitura me	Vlerësimi dhe identifikimi i rezultateve profesionale më të spikatura dhe më të shkëlqyera. Rezultatet e vlerësimit profesionale të nxjerrë nga 5 dokumente të paraqitura dhe përzgjedhura nga vetë kandidatët si më të përshtatshmet për t’u shqyrtuar, të cilat vlerësohen nga Këshilli në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar, për tregues të tillë si: - Originaliteti	(5 pikë për cdo komponent / dokument)		Këshilli mund të marrë në konsideratë sasinë si edhe cilësinë e rezultateve profesionale, duke vendosur sistem pikëzimi për cdo libër shkencor ose artikull shkencor të botuar, institucionin ku është botuar, impaktin, kërkesat e pranuar të avokatëve në Gjykatën Kushtetuese, çështjet paragjykimore të paraqitura si gjyqtar e të pranuar nga Gjykata Kushtetuese, etj. (në cdo rast duke kontrolluar edhe <u>plagjiatura</u> per punimet akademike)

<p>kontribute nga kandidati, - përfaqësime të ndryshme të interesave publike ose private përpara organeve të drejtësisë ose institucioneve brenda apo jashtë vendit, - botime shkencore, prezantime, artikuj dhe publikime shkencore e profesionale.</p> <p>Dokumente, ndërmjet atyre të treguara më sipër, të përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli.</p> <p>Dokumente zyrtare për rezultatet e procesit të vlerësimit profesional.</p> <p>Dokumente zyrtare që</p>	<p>(përfshirë edhe kontrollin e plagjiaturës) - Impakti i dokumentit në veçanti në zhvillimin a krijimin e jurisprudencës gjyqësore, dhe në elaborimin e doktrinës juridike; - Aftësitë analitike; - Aftësitë hulumtuese; - Saktësia dhe konciziteti; - Zhvillimi logjik i koncepteve juridike, lexueshmëria, kuptueshmëria dhe gjithëpërfshirja; - Aftësia për të identifikuar dhe interpretuar në mënyrë të harmonizuar burimet e ndryshme të së</p>			<p>Këshilli mund të akordojë pikë të vecanta nëse kjo veprimtari është kryer edhe në vendet e BE/OECD apo në gjuhë të huaja.</p> <p>(mund të merren më shumë ide nga metodologjia per pikëzimin dhe renditjen)</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

tregojnë cilësinë dhe arritjet gjatë përvojave të punës, nga institucione vendase ose ndërkombëtare.

Statistika profesionale nga institucione kompetente

drejtës, si dhe kurajë profesionale për të treguar dhe argumentuar ligjin e zbatueshëm për zgjidhjen e problemit;
- Aftësia për të referuar dhe trajtuar me efektivitet, në vendin e duhur dhe sipas llojit e qëllimit të aktit, të praktikës e konsoliduar gjyqësore, praktikës së unifikuar të Gjykatës së Lartë, praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, asaj të GJEDNJ-së, GJDBE-së dhe jurisprudencës në tërësi.

C. Kualifikimi shtesë profesional <i>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(a); Ligji nr. 98/2016, Neni 31(1)(2)</i>			30		
<p>Specializim në fushen e:</p> <p>A. të drejtës civile, duke përfshirë të drejtën tregtare dhe familjare, ose</p> <p>B. të drejtës penale, ose</p> <p>C. të drejtës administrative</p> <p>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(a)</p> <p>a) ekspertizën e veçantë të kandidatit në fusha të veçanta të ligjit, sipas kërkesave të shpallura për pozicionin e lirë.</p> <p>Ligji nr. 98/2016, Neni 31(1)(2)</p> <p>1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. (...).</p> <p>2. Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, (...).</p> <p>Kushtetuta Neni 136(3)</p> <p>(...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur (...).</p>	<p>Jetëshkrimi</p> <p>Dokumente zyrtare për angazhimin dhe rezultatet e procesit të vlerësimit profesional.</p> <p>Dokumente profesionale që tregojnë fushën e specializimit, krahas cilësisë dhe arritjeve gjatë përvojave të punës, ku mund të përfshihen, por pa u kufizuar vetëm në to, edhe dokumentet e përzgjedhura nga vetë kandidati, që vlerësohen bazuar në metodologjinë profesionale të miratuar posaçërisht nga Këshilli.</p>	<p>Kandidatët që kanë <u>ekspertizë në një fushë specifike</u> të ligjit vlerësohen në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - kohëzgjatjen e angazhimit në këtë fushë - botimet relevante - ndikimi i rezultateve profesionale në këtë fushë, në krijimin e zhvillimin e jurisprudencës dhe të doktrinës juridike, - konsulenca në fushën e së drejtës; - konsulenca në fushën e së drejtës në vendet e BE/OECD - etj. 			<p>Kandidatët që kanë ekspertizë në një fushë të caktuar juridike vlerësohen në lidhje me:</p> <p><u>6 pikë - kohëzgjatja e angazhimit në fushën specifike:</u></p> <p>1 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje nga 1 deri në 3 vjet</p> <p>2 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 3 deri në 6 vjet</p> <p>3 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 6 deri në 9 vjet</p>

	<p>Dokumentet zyrtare për angazhimet profesionale.</p> <p>Dokumentet, mes atyre që u përmendën më lart, të përzgjedhura nga vetë kandidati, duke dëshmuar angazhimin, ekspertizën dhe ndikimin e angazhimit.</p> <p>Informata specifike zyrtare dhe dokumente mbi pjesëmarrjen në veprimtari shkencore, hartimin e legjislacionit dhe aktivitete të tjera profesionale.</p>	<p>Rezultatet profesionale vlerësohen nga Këshilli në lidhje me rëndësinë dhe dobinë e profilizimit dhe specializimit të arritur në përvojën e veçantë profesionale të kandidatit, për të pasuruar kapacitetet profesionale të Gjykatës së Lartë me profesionistë të spikatur nga fusha e së drejtës civile, penale dhe administrative.</p> <p>Lloji dhe kohëzgjatja e angazhimit të posaçëm apo të profilizuar, për fusha konkrete të së drejtës: - në veprimtari të caktuara</p>			<p>4 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 9 deri në 12 vjet</p> <p>5 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 12 deri në 15 vjet</p> <p>6 pikë - për angazhimin në fushën specifike për një kohëzgjatje mbi 15 vjet</p> <p>2 pikë - botime relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në këtë fushë</p> <p>2 pikë shtesë - botimet relevante dhe ndikimi i rezultateve profesionale në këtë fushë të publikuara në vendet e</p>
--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

		<p>profesionale; - në funksione institucionale, të lidhura me ushtrimin e profesionit.</p> <p>Lloji dhe rëndësia e angazhimeve të tjera profesionale në pesë vitet e fundit.</p> <p>Natyra dhe shkalla e kontributit konkret të dhënë në këto veprimtari, ku vlerësohen, por pa u kufizuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - prezantimet në konferencashkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; - pjesëmarrja si përfaqësues, ekspert etj. në organizata ndërkombëtare; - pjesëmarrja në grupe pune dhe 			<p>BE / OECD</p> <p>2 pikë shtesë - për impaktin e botimeve relevante në zhvillimin e doktrinës dhe të jurisprudencës gjyqësore</p> <p>4 pikë - konsulencat në fushën e së drejtës dhe në veçanti e shoqëruar me kontributet në hartimin e legjislacionit (bazuar në të dhëna të dokumentuara)</p> <p>2 pikë shtesë - konsulenca në fushën e ligjit në vendet e BE / OECD</p> <p>Këshilli mund të vlerësojë në veçanti edhe:</p> <p>2 pikë - prezantime në</p>
--	--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

		<p>kontributet konkrete në nisma të konsultimit dhe procese legjislativ për hartimin e legjislacionit;</p> <ul style="list-style-type: none"> - konsulenca profesionale të dokumentuara; - pozicione përkatëse si i/e ftuar nderi dhe angazhime të njohura në fushën juridike. <p>Ecuria dhe ngritja në karrierë e kandidatit, në institucione shtetërore brenda a jashtë vendit, në nivelet e organeve të sistemit të drejtësisë (Gjykatë/ Prokurori e Shkallës së Parë e deri në GJL, GJK, PP, në administratën</p>			<p>konferencat shkencore kombëtare (bazuar në fjalimet e dorëzuara)</p> <p>2 pikë shtesë - prezantimet në konferencat shkencore ndërkombëtare në vendet e BE / OECD (bazuar në fjalimet e dorëzuara)</p> <p>3 pikë - pozicione nderi dhe angazhimet përkatëse në fushën ligjore</p> <p>2 pikë - përvojë si pedagog me kohë të plotë ose me kohë të pjesshme si pedagog ose si "profesor vizitor" në vendet e BE / OECD</p> <p>2 pikë - çmime, bursa ose tituj të veçantë</p>
--	--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

		publike, në institucione arsimore e shkencore etj)			nderi në vendet e BE / OECD 3 pikë - mësimdhënie për profesionistët (p.sh. gjyqtarët, prokurorët, avokatët etj.) (Shënim: Juristët e spikatur mund të vërehen nga eksperiencia e tyre e mëparshme e vecantë në Shqipëri apo në institucionet ndërkombëtare apo në vendet e BE / OECD)
Meritat morale dhe etike <i>Kushtetuta Neni 136(3), Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b)</i>			15		
Integriteti moral dhe etik <i>Kushtetuta Neni 136(3)</i> (...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur (...).	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare që	Niveli e kërkuar e i pritshëm i shkallës së lartë të zotërimit të integritetit etik			(Shënim: Ndarja e pikëve specifike për secilin komponent mund të bëhet duke iu

<p>Ligji nr. 96/2016, Neni 49(6)(b) b) vlerësimin e punës së kandidatit (...);</p>	<p>tregojnë arritje mbi nivelin e etikës dhe cilësive morale gjatë përvojave të punës.</p> <p>Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë.</p> <p>Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht</p>	<p>dhe të cilësive morale të domosdoshme për ushtrimin e funksionit të gjyqtarit të Gjykatës së Larte.</p> <p>Paraqitja, sjellja, cilësia, besueshmëria, dinjiteti dhe profesionalizmi i treguar gjatë intervistës.</p> <p>Gatishmëria, korrektësia, saktësia dhe cilësia në komunikimet me Këshillin gjatë procedurave të verifikimit dhe vlerësimit, si edhe në</p>		<p>referuar komponentëve të Nenit 240 të Ligjit për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, si dhe Sistemit të Pikëzimit për ngritjen në Detyrë të Gjyqtarëve)</p>
-----------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	ose të paraqitura në Këshill.	përgjigjet e parashtruara gjatë zhvillimit të intervistës. Performanca profesionale dhe jetësore e kandidatit/es në shoqëri, në publik dhe ndërmjet kolegëve.			
MERITAT ORGANIZATIVE DHE MERITA PERSONALE TË TJERA			10		
(Shënim: KLGj në kërkim të “juristëve të spikatur” për në Gjykatën e Lartë, në zbatim të Kushtetutës: Neni 136(3) (...) Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes <u>juristëve të spikatur</u> (...). Mund t’i referohet për ide edhe: Neni 240 të Ligjit për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë, Neni 74 (Aftësitë Organizative) dhe Neni 76 (Aftësitë	Jetëshkrimi. Intervista me kandidatin Dokumente zyrtare që tregojnë arritje mbi nivelin e meritave organizative dhe meritave personale të	Performanca profesionale dhe jetësore e kandidatit/es në shoqëri, në publik dhe ndërmjet kolegëve.			2 pikë - Cilësinë e platformës dhe të vizionit që paraqesin 4 pikë - Aftësitë e provuara organizative dhe për të marrë vendime dhe

Përsone dhe Profesionale të Tjera) të Ligjit për Statusin	<p>tjera gjatë përvojave të punës.</p> <p>Informacione zyrtare të ardhura posaçërisht ose të bëra vetë publike nga institucione të tjera shtetërore.</p> <p>Informacione dhe opinione të ardhura nga institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizata të shoqërisë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë.</p> <p>Informacione dhe dokumente të tjera të aksesueshme publikisht ose të paraqitura në</p>			<p>përgjegjësi bazuar në përvojat e mëparshme profesionale dhe shoqërore</p> <p>2 pikë - Aftësitë e komunikimit</p> <p>2 pikë - Aftësitë e të punuarit në grup dhe në ambiente multidisiplinore ose multikulturore dhe aftësitë e përfaqësimit publik.</p>
-----------------------------------------------------------	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--	--	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

	Këshill.			
TOTALI I PIKËVE PËR RENDITJEN E KANDIDATIT			TOTALI I PIKËVE	PIKËZIMI NGA KLGJ
			100	